

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Na ndërpreu takimin dhe mallkoi banorët", Braçe reagon pas përplasjes me aktivisten
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/na-nderpreu-takimin-dhe-mallkoi-banoret-brace-reagon-pas-perplasjes-me--i588606
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 17:43:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 17:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	727ea1d62634bc50aa16abaa708ca91fe75a91e8cbbfece72227341f1ed939dd
TEKSTI	8af0c1dc1ae40f81c6ee9afeaec1969cabdbff0e17964edfce78403ede2cab9
PAMJA	78b238b097575c37d654584fe622b37b19f1439120ddeb6283c9d43382a3bec

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d36feb4c6c5da9e835c552964f755218c869146e85e5bc055f5c45603742d45f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f1d82a646bd703b2c3db300ad07fe31d63113d7410715c948367b3c04c7e5621
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d36feb4c6c5da9e835c552964f755218c869146e85e5bc055f5c45603742d45f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



Me shume se nje shkolle, gjuha shqipe ne FIRENCE nis vitin e dyte te misionit te saj identitar "Na nderpreu takimin dhe mallkoi banoret". Braçe reagon pas perplasjes me a fundit

“Na ndërpreu takimin dhe mallkoi banorët”, Braçe reagon pas përplasjes me aktivisten



26 Shtator 2026, 19:40Politika TEMA



Pas debatit të një dite më parë me aktivisten Arvina Lleshi gjatë takimit me banorët pranë shkollës “Vasil Shanto”, deputeti i Partisë Socialiste, Erion Braçe, ka reaguar përmes një postimi të gjatë, duke dhënë versionin e tij për atë që ndodhi.

Braçe publikon edhe detaje nga takimi, duke mohuar që ndaj Lleshit të ketë pasur fyerje apo përplasje fizike dhe pretendon se aktivistja, së bashku me persona të tjerë, ka ndërprerë takimin dhe ka fyer banorët e pranishëm.

Deputeti thotë se gjatë takimit janë evidentuar dhjetëra ankesa të banorëve, ndërsa shprehet se pamjet e kamerave tregojnë, sipas tij, dinamikën e plotë të ngjarjes.

“E VËRTETA PËR TAKIMIN TIM DJE; POR EDHE PËR ARVINËN, GRUPIN E SAJ TEKNIK, SHARJET, FYERJET, MALLKIMET NDAJ NJERËZVE NË TAKIM!

(Një sqarim përmes videoeve të kamerave në takim, për portalet dhe mediat serioze që nuk bëjnë as minimumin për të ditur të vërtetën)

Dje kisha lajmëruar një takim me disa blloqe rreth shkollës VASIL SHANTO, për të bërë atë që bëj çdo ditë – dëgjim, shënim, rekomandim, ndjekje, ZGJIDHJE.

Para se të niste takimi, e njohura si Arvina Lleshi, bashkë me grupin e saj që e tutelonte në terren dhe një tjetër në telefon, nisi të thërrasë nga matanë rrugës.

E kam ftuar të afrohet, ka ardhur pa bërë titur, kemi shkëmbyer përshëndetje, e kam pyetur për shëndetin – nisur nga ç’kish ndodhur ditë më parë, më tha që kishte ardhur për mua; E KAM FTUAR TË VIJË NË TAKIM E TË DËGJOJË, MOS THËRRASË NGA RRUGA; është bindur, ka ardhur, ka ndenjur, ka ikur, ka ardhur përsëri, ka ndenjur nëpër stola, është bërë pjesë e takimit;

JAKU E KENI, SHIHNI KAMERAT RRETH TAKIMIT, ËSHTË ARVINA, SHOQJA E SAJ, UNË QË E FTOJ TË VIJË NË TAKIM, SHOKËT E SAJ.

Unë kam marrë gjatë takimit 42-43 ankesa, shqetësime, halle personale dhe komunitare nga 38 banorë; nga e hëna nisen në institucione për përgjigje, zgjidhje që njerëzit presin; ARVINA I DËGJOI SA MUNDI QETËSISHT, PËR SHKAK SE AI QË E TUTELONTE NGA TELEFONI I SHKRUANTE PA PUSHIM.

Pranë orës 18.00 e humbi qetësinë dhe hyri në rol; nisi të shajë, të fyejë, madje deri të mallkojë njerëzit që ishin aty e që deri në atë moment, jo vetëm kishin

treguar hallet, por edhe kishin shprehur pakënaqësi e kritika.

Kam reaguar unë disa herë, pastaj njerëz që ishin krejt të rastësishëm aty, për herë të parë, për shkak të takimit; ASKUSH NUK ËSHTË ZËNË, ASKUSH NUK E KA FYER E OFENDUAR; madje disa janë sjellë si PRINDËR me të, prindër të dashur, as të dhunshëm e as VRASËS – apo jo Arvina; dikush i dha çamçakëz për të bërë poca, dikush kamelele për hapje fyt, dikush monedha për kafe, për t’u qetësuar.

ARVINA THA QË ISHTE PA PUNË, POR ARVINA ËSHTË NË PUNË, KËTË PUNË QË E BËN ÇDO DITË DHE KA TË ARDHURA PREJ SAJ.

Disa fjalë më shumë dje, një kor që në nisje, ma bëri pjesë të një OLIGARKU KËLLIRË, MË I MADHI SOT NË POLITIKË”, shkruan Braçe.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Komisioni Hetimor për zgjedhjet e 11 majit, PD kërkon nisjen e procedurave: Vendimi i Kushtetueses është detyrues

17:40 Politika

Wendt në Tiranë, ambasada amerikane zbardh detaje pas takimit me Begajn: Diskutuan për çuarjen përpara të përparësive të administratës Trump

16:30 Politika

"Shkova bashkë me Argitën" - E akuzoi se ka kaluar nga zyra e Agasit, Berisha "zbythet" ndaj ministres Ismaili: Ishte deklaratë politike!

15:33 Politika / 14 komente

Begaj pret ambasadorin e ri amerikan Eric Wendt: SHBA, partner i pazëvendësueshëm për Shqipërinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.